



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA E SHKALLËS SË PARË
PËR KRIME TË RËNDA

NR. AKTI 24
30.07.2015

NR. VENDIMI 17
02.08.2015

V E N D I M
“NË EMËR TË REPUBLIKËS”

Gjykata e Shkallës së Parë për Krime të Rënda Tiranë, e përbërë prej:

Ardit MUSTAJ - GJYQTAR

Asistuar prej sekretares Olta Sinanaj, sot me dt.02.08.2015, mori në shqyrtim në seancë gjyqësore kërkesën e paraqitur prej:

KËRKUES: Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda, Tiranë, përfaqësuar me autorizim nga prokurore Doloreza Musabelliu.

OBJEKTI:

1. Sekuestrim i pasurive të paluajtshme të personit të dyshuar A. N..
2. Për administrimin e pasurive të caktohen administratorët e Agjensisë për Administrimin e Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara, K. Xh. dhe S. M., ndërsa për ekzekutimin e këtij vendimi të ngarkohet Zyra përkatëse e Përmbartimit.
3. Pezullimin e zbatimit të masës së sekuestrimit të pasurive, deri në dhënien e një vendimi gjyqësor për revokimin ose shuarjen e masës së sekuestrimit preventive të dhënë mbi të njëjtat pasuri nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor xxxx me vendimin xxxx, dt.xxxx.

BAZA LIGJORE: Nenet 3-7, 11, 12, 14, 15 e vijues të ligjit nr.10192, dt.3.12.2009 “Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar, trafikimit dhe korrupsionit nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë”.

Gjykata, pasi shqyrtoi aktet dhe dëgjoi prokuroren që kërkoi pranimin e kërkesës;

VËREN SE:

Prokuroria për Krime të Rënda Tiranë ka filluar procedimin pasuror nr.x,

dt.xxxx, sipas ligjit nr.10192, dt.3.12.2009 “Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar, trafikimit dhe korrupsionit nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë” (në vijim ligji nr.10192/2009), në lidhje me pasuritë e shtetasit A. N. (ose A. L.).

Ky procedim pasuror ka filluar mbi bazën e dhënave të dërguara nga Prokuroria e Rrethit Gjyqësor xxxx me shkresën nr.xxxx prot., dt.xxxx dhe relacionin shpjegues të kësaj prokurorie lidhur me çështjen penale nr.xxxx. Sipas tyre, rezulton se Prokuroria e Rrethit Gjyqësor xxxx, me dt.xxxx ka filluar çështjen penale për veprën penale të “Pastrimit të produkteve të veprës penale ose të veprimtarisë kriminale”, të parashikuar nga neni 287 i K.Penal, ndaj shtetasit shqiptar A. N.. Ndaj shtetasit A. N., të ndryshuar këto gjeneralitete në A. L., i biri i U. dhe i R., i datëlindjes xxxx, lindur në xxxx, posedues i pasaportës shqiptare xxxx, lëshuar në dt.xxxx, nga informacioni dt.xxxx i Zyrës së Interforce në xxxx (misioni i policisë italiane në Shqipëri në kuadër të bashkëpunimit me policinë shqiptare), është caktuar masa e sigurimit “arrest në burg” me vendimin nr.xxxx xxxx xxxx xxxx, dt.xxxx të gjyqtarit për hetime paraprake pranë Gjykatës së Milanos, për trafik lëndësh narkotike, të kryer në bashkëpunim, si dhe është caktuar edhe një masë tjetër sigurimi “arrest në burg” me vendimin nr.xxxx xxxx, dt.xxxx, të gjyqtarit për hetime paraprake të Gjykatës në Lucca, për shkelje të ligjit për lëndët narkotike. Po kështu, nga shkresa nr.xxxx prot., dt.xxxx e Zyrës së Interpol Tirana, rezulton se shtetasi i mësipërm është arrestuar me dt.xxxx në Serbi dhe me dt.xxxx është ekstraduar drejt Italisë.

Procedimi penal i mësipërm në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor xxxx rezulton se është akoma në hetim, pasi është në pritje të letërporosisë së dërguar autoriteteve gjyqësore italiane për të marrë të dhëna të plota në lidhje me veprat penale dhe vendimet penale të dhëna në Itali ndaj këtij shtetasi.

Nga hetimi i kryer nga Prokuroria e Rrethit Gjyqësor xxxx, akte që i janë përcjellë Prokurorisë për Krime të Rënda, siç u përmend më lart, rezultojnë të regjistruar në emër të shtetasit A. N. dhe familjarëve të tij një numër pronash të paluajtshme, të cilat janë krijuar/fituar pas vitit 2005-2007 për të cilat bëjnë fjalë masat e sigurimit të sipërcituara të vendosura nda autoritetet italiane. Konkretisht, sipas procesverbalit dt.xxxx të kqyrjes së regjistrave në Zyrën e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme xxxx, figurojnë këto pasuri (për të cilat prokuroria ka paraqitur edhe kërkesën objekt gjykimi):

a) Pasuria me nr.xxxx, e ndodhur në ZK xxxx (qyteti i xxxx), lloji i pasurisë Hotel-Bar-Restorant, me sipërfaqe totale xxxx m², e regjistruar më dt.xxxx, në emër të shtetasve A. Y.N., A. U. N. dhe E. U. N., e cila përfshin:

-një godinë x-katëshe të ndodhur në qytetin e xxxx, e quajtur “xxxx”, Hotel-Bar-Restorant, ku përfshihen: kati përdhe me sipërfaqe xxxx m²; kati x+x me sipërfaqe xxxx m²; kati x me sipërfaqe xxxx m²; kati x me sipërfaqe xxxx m².

b) Pasuria me nr.xxxx, e ndodhur në ZK xxxx (qyteti i xxxx), lloji i pasurisë godinë x kate banimi + x kat papafingo + x kat bodrum (parking), e regjistruar më dt.xxxx, në emër të shoqërisë “xxxx” sh.p.k, ku figurojnë si ortakë shtetasit A. Y. N., A. U. N. dhe E. U. N., e cila përfshin:

-pasuria me nr.xxx, ndodhur në ZK xxxx, kati nëntokë që shërben si parking, me sipërfaqe xxxx m²;

-pasuria me nr.xxxx, ndodhur në ZK xxxx, kati përdhe që shërben si njësi tregtimi, me sipërfaqe xxxx m²;

-pasuritë me nr.xxxx, ndodhur në ZK xxxx, kati x-x, që shërbejnë si apartamente banimi.

c) Pasuria me nr.xxxx, e ndodhur në ZK xxxx (qyteti i xxxx), lloji i pasurisë godinë x kate banimi + x kat papafingo + x kat bodrum (parking), regjistruar më dt.xxxx, në emër të shoqërisë “xxxx” sh.p.k, ku figurojnë si ortakë shtetasit A. Y. N., A. U. N. dhe E. U. N., e cila përfshin:

-pasuria me nr.xxxx, ndodhur në ZK xxxx, kati nëntokë që shërben si parking, me sipërfaqe xxx m²;

-pasuria me nr.xxxx, ndodhur në ZK xxxx, kati përdhe që shërben si njësi tregtimi, me sipërfaqe xxx m²;

-pasuritë me nr.xxxx, ndodhur në ZK xxxx, kati x-x, që shërbejnë si apartamente banimi.

ç) Pasuria me nr.xxxx, e ndodhur në ZK xxxx (qyteti i xxxx), lloji i pasurisë godinë me x kate njësi tregtare, x kate banimi + x kat Pub Panoramik + x kat bodrum (parking), regjistruar më dt.xxxx, në emër të shtetase A. U. N. dhe E. Q. K., e cila përfshin:

-pasuria me nr.xxxx, ndodhur në ZK xxxx, kati nëntokë që shërben si parking, me sipërfaqe xxxx m²;

-pasuritë me nr.xxx, xxx dhe xxxx, të ndodhura në ZK xxxx, që shërbejnë si njësi tregtimi;

-pasuritë me nr.xxx-xxxx, ndodhur në ZK xxxx, kati x-x, që shërbejnë si apartamente banimi.

Për pasuritë e mësipërme, rezulton se në kuadrin e hetimit penal Gjykata e Rrethit Gjyqësor xxxx, me vendimin nr.xxx, dt.xxxx, ka vendosur sekuestron preventive, bazuar në nenin 274/2 të K.Pr.Penale.

Prokuroria për Krime të Rënda Tiranë, pa kryer ndonjë veprim hetimor, ka paraqitur në gjykatë, menjëherë me marrjen e akteve nga Prokuroria e rrethit xxxx, kërkesën objekt gjykimi. Sipas prokurorisë, në kushtet e mësipërme ekziston dyshimi se shtetasi A. N. ka kryer veprën penale të “Pastrimit të produkteve të veprës penale ose të veprimtarisë kriminale” të parashikuar nga neni 287 i K.Penal, e cila hyn në kategorinë e atyre të parashikuara nga neni 3/1 i ligjit nr.10192/2009 dhe për këtë shtetas dhe personat e lidhur me të, sipas nenit 3/1 dhe 3/2 të këtij ligji, duhet të aplikohen masat e parashikuara nga ky ligj për pasuritë e tyre.

Sipas prokurorisë, ekziston një rrezik real dhe potencial që në përfundim të procedimit penal të mësipërm, në varësi të zgjidhjes përfundimtare, kjo pasuri të tjetërsohet dhe të humbasë, është e nevojshme vendosja e masës së sekuestrimit, në bazë të nenit 11/1/a të ligjit nr.10192/2009.

Gjykata, çmon se kërkesa e prokurorisë për sekuestrimin e pasurive duhet pranuar pjesërisht, vetëm për pasuritë e regjistruara në emër të shtetasve A. N., A. N., E. N. dhe të shoqërisë “xxxx” sh.p.k, pasi për këtë pjesë plotësohen kriteret e kërkuara nga nenet 3 dhe 11 të ligjit nr.10192/2009. Ndërsa për pjesët takuese të shtetasit E. K. (person i tretë) gjykata konstaton se nga prokuroria nuk është bërë asnjë hetim në drejtim të këtij shtetasi dhe nuk është paraqitur në këtë gjykim asnjë provë që të vertetojë lidhjet mes tij dhe personit të dyshuar A. N., nëse ky person hyn në rrethin e personave (të tjerë) që parashikon neni 3/2 gërma “b” e ligjit nr.10192/2009 (meqenëse nuk ka asnjë provë që të tregojë se ky person hyn në rrethin e personave të afërm të shtetasit A. N. sipas nenit 3/2 gërma “a” e ligjit) dhe për pasojë kërkesa e prokurorisë, për pjesën e tij takuese në pasuri, duhet rrëzuar si e pabazuar, pasi nuk përmbushen kushtet dhe kriteret e neneve 3/2 gërma “b” dhe 11 të ligjit nr.10192/2009.

Neni 11/1 i ligjit nr.10192/2009, në të cilin bazohet kërkesa e prokurorit, konkretisht parashikon:

“1. Me kërkesë të motivuar të prokurorit, gjykata vendos sekuestrimin e pasurive të personave, sipas nenit 3 të këtij ligji, kur ekziston një dyshim i arsyeshëm, i bazuar në indicie që tregojnë se personi mund të jetë i përfshirë në veprimtari kriminale dhe zotëron pasuri apo të ardhura, që nuk i përgjigjen dukshëm nivelit të të ardhurave, fitimeve apo veprimtarive të ligjshme, të deklaruara dhe as nuk justifikohen prej tyre dhe kur:

a) ekziston një rrezik real për humbje, marrje apo tjetërsim të fondeve, pasurive apo të drejtave të tjera, mbi të cilat parashikohet vënia në zbatim e masës së konfiskimit, sipas dispozitave të këtij ligji; ose

b) ka dyshime të arsyeshme që tregojnë se zotërimi i pasurive dhe ushtrimi i veprimtarive të caktuara ekonomike, tregtare dhe profesionale janë në gjendje rreziku apo ndikimi nga ana e një organizate kriminale ose që mund të lehtësojnë veprimtaritë kriminale.

...”

Pra, për vendosur sekuestrimin e pasurive nevojitet që personi të jetë i dyshuar për të paktën një nga veprat penale të parashikuara në nenin 3/1 të ligjit dhe se pasuritë apo të ardhurat që zotëron ai ose personat e lidhur me të (sipas nenit 3/2 të ligjit) të mos i përgjigjen dukshëm nivelit të të ardhurave, fitimeve apo veprimtarive të ligjshme, të deklaruara, dhe as nuk justifikohen prej tyre. Krahas këtyre, nevojitet që të ekzistojë edhe një nga rastet e parashikuara në gërmat “a” dhe “b” të nenit 11/1 të ligjit.

Shtetasi A. N. rezulton se është subjekt i zbatimit të ligjit nr.10192/2009, pasi, siç parashikohet në nenin 3/1/d të ligjit, në ngarkim të tij ekziston një dyshim i arsyeshëm, i bazuar në indicie, për kryerjen e veprës penale të parashikuar nga neni 287 i K.Penal, kjo e lidhur edhe me të dhënat paraprake të marra nga autoritetet italiane, siç u përmend më lart.

Nga të dhënat e marra nga Qendra Kombëtare e Regjistrimit, rezulton se personi juridik “xxxx” sh.p.k. ka si ortakë shtetasit A. N., A. N. (i dyshuari) dhe E. N. (vëllai i të dyshuarit), secili me x % të kuotave të shoqërisë.

Sipas nenit 3/4 të ligjit nr.10192/2009, ky ligj zbatohet edhe për pasuritë e personave, të krijuara përpara hyrjes në fuqi të tij, me kusht që pasuritë të jenë vënë gjatë përfshirjes së dyshuar të personit në veprimtarinë kriminale, sipas këtij ligji. Në rastin konkret pasuritë e mësipërme rezulton se janë krijuar pas periudhës të përfshirjes së dyshuar në aktivitetin kriminal të përmendur më lart.

Në rastin në gjykim, prokuroria ka kryer verifikime në lidhje me aktivitetet ekonomike dhe të ardhurat e mundshme të realizuara nga subjekti A. N. dhe personat e afërm të tij, në emër të të cilëve figurojnë pasuritë e mësipërme, dhe nga të dhënat paraprake rezulton e dyshimtë që vlera e madhe e pasurive të mësipërme të mbulohet nga të ardhura të ligjshme të tyre.

Nga ana tjetër, gjykata vlerëson se në lidhje me pasuritë e mësipërme potencialisht ekziston në çdo kohë rreziku i tjetërsimit dhe i shkakimit të pamundësisë për të zbatuar masat parandaluese të parashikuara në këtë ligj, pasi kalimi i pronësisë mund të bëhet nëpërmjet kryerjes së veprimeve juridike përkatëse dhe regjistrimit të tyre në ZRPP, pa qenë e nevojshme edhe dorëzimi i pasurive. Për pasojë, me përfundimin i procedimit penal të sipërpërmendur dhe rënien e mundshme nga fuqia të masës së sekuestros preventive, në çdo kohë është i mundur tjetërsimi i këtyre pasurive nga subjekti A. N. dhe të afërmit e tij. Prandaj, ekziston rreziku real i tjetërsimit të pasurive të sipërcituara dhe për rrjedhojë gjykata vlerëson se përmbushet edhe kërkesa e nenit 11/1 gërma “a” e ligjit nr.10192/2009.

Gjykata sqaron se masa parandaluese e sekuestros sipas ligjit nr.10192/2009, është masë me karakter të përkohshëm, me afate të përcaktuara në ligj, që lidhet patjetër me

ekzistencën e një hetimi pasuror të filluar dhe ka si qëllim ruajtjen e pasurive të të gjitha llojeve nga humbja apo tjetërsimi dhe, në të njëjtën kohë, heqjen e mundësisë së përdorimit të mëtejshëm të tyre në veprimtaritë kriminale. Kjo masë është në funksion të realizimit të qëllimit kryesor të hetimit pasuror që zhvillohet sipas këtij ligji, atij të konfiskimit të pasurisë kur vertetohen kushtet e parashikuara në këtë ligj.

Gjithashtu, sipas nenit 5/3 të ligjit nr.10192/2009, ekzistenca e masave të sekuestros të vendosura në hetimin penal mbi pasuritë, nuk pengon marrjen e masave parandaluese (sekuestrimi, konfiskimi) të parashikuara në këtë ligj, por pasojat zbatimit të tyre pezullohen sa kohë janë në fuqi masat e marra në procedimin apo gjykimin penal.

Së fundmi, gjykata nënvizon se megjithëse gjykimi i kërkesës për sekuestrim sipas ligjit nr.10192/2009 bëhet vetëm me pjesmarrjen e prokurorit (neni 12/1), shtetasit që preken nga masa parandaluese duhet të njoftohen nga gjykata (sekretaria e gjykatës) për vendimin e dhënë në mungesë të tyre dhe ata kanë të drejtën e ankimit në gjykatën e apelit (nenet 14/2 dhe 27/1).

PËR KËTO ARSYE:

Gjykata, bazuar në nenet 3, 5, 7, 11, 12, 14, 15, 26, 27 të ligjit nr.10192, dt.3.12.2009 “Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar, trafikimit dhe korrupsionit nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë” të ndryshuar, si dhe nenet 126, 306 e vijues të K.Pr.Civile,

VENDOSI:

1. Sekuestrimin e pasurive të paluajtshme si më poshtë:

a) Pasuria me nr.xxx, e ndodhur në ZK xxxx (qyteti i xxxx), lloji i pasurisë Hotel-Bar-Restorant, me sipërfaqe totale xxxx m², e regjistruar më dt.xxxx, në emër të shtetasve A. Y. N., A. U. N. dhe E. U. N., e cila përfshin:

-një godinë x-katëshe të ndodhur në qytetin e xxxx, e quajtur “xxxx”, Hotel-Bar-Restorant, ku përfshihen: kati përdhe me sipërfaqe xxxx m²; kati x+x me sipërfaqe xxxx m²; kati x me sipërfaqe xxxx m²; kati x me sipërfaqe xxxx m².

b) Pasuria me nr.xxx, e ndodhur në ZK xxx (qyteti i xxxx), lloji i pasurisë godinë x kate banimi + x kat papafingo + x kat bodrum (parking), e regjistruar më dt.xxxx, në emër të shoqërisë “xxxx” sh.p.k, ku figurojnë si ortakë shtetasit A. Y. N., A. U. N. dhe E. U. N., e cila përfshin:

-pasuria me nr.xxxx, ndodhur në ZK xxxx, kati nëntokë që shërben si parking, me sipërfaqe xxx m²;

-pasuria me nr.xxx, ndodhur në ZK xxx, kati përdhe që shërben si njësi tregtimi, me sipërfaqe xxx m²;

-pasuritë me nr.xxx, ndodhur në ZK xxx, kati x-x, që shërbejnë si apartamente banimi.

c) Pasuria me nr.xxxx, e ndodhur në ZK xxxx (qyteti i xxxx), lloji i pasurisë godinë x kate banimi + x kat papafingo + x kat bodrum (parking), regjistruar më dt.xxxx, në emër të shoqërisë “xxxx” sh.p.k, ku figurojnë si ortakë shtetasit A. Y. N., A. U. N. dhe E. U. N., e cila përfshin:

-pasuria me nr.xxx, ndodhur në ZK xxxx, kati nëntokë që shërben si parking, me sipërfaqe xxx m²;

-pasuria me nr.xxxx, ndodhur në ZK xxxx, kati përdhe që shërben si njësi tregtimi, me sipërfaqe xxx m²;

-pasuritë me nr.xxxx, ndodhur në ZK xxxx, kati x-xx, që shërbejnë si apartamente banimi.

ç) Pasuria me nr.xxx, e ndodhur në ZK xxxx (qyteti i xxxx), lloji i pasurisë godinë me x kate njësi tregtare, x kate banimi + x kat Pub Panoramik + x kat bodrum (parking), regjistruar më dt.xxxx, në emër të shtetase A. U. N. dhe E. Q. K., e cila përfshin: pasuria me nr.xxx, ndodhur në ZK xxxx, kati nëntokë që shërben si parking, me sipërfaqe xxx m²; pasuritë me nr.xxx, xxx dhe xxx, të ndodhura në ZK xxx, që shërbejnë si njësi tregtimi; pasuritë me nr.xxx-xxx, ndodhur në ZK xxx, kati x-x, që shërbejnë si apartamente banimi; vetëm për pjesën takuese të shtetasit A. U. N..

2. Rrëzimin e kërkesës për sekuestrimin e pasurisë me nr.xxx, e ndodhur në ZK xxxx (qyteti i xxxx), lloji i pasurisë godinë me x kate njësi tregtare, x kate banimi + x kat Pub Panoramik + x kat bodrum (parking), regjistruar më dt.xxxx, në emër të shtetase A. U. N. dhe E. Q. K., e cila përfshin: pasuria me nr.xxx, ndodhur në ZK xxxx, kati nëntokë që shërben si parking, me sipërfaqe xxx m²; pasuritë me nr.xxx, xxx dhe xxx, të ndodhura në ZK xxx, që shërbejnë si njësi tregtimi; pasuritë me nr.xxx-xxx, ndodhur në ZK xxx, kati x-x, që shërbejnë si apartamente banimi; për pjesën takuese të shtetasit E. Q. K..

3. Pezullimin e pasojave të zbatimit të kësaj mase parandaluese deri në revokimin apo shuarjen e masës së sekuestros preventive të vendosur, sipas nenit 274 të K.Pr.Penale, me vendimin nr.xxx, dt.xxxx të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor xxxx.

4. Për ekzekutimin e masës së sekuestros ngarkohet Zyra e Përmbarrimit Gjyqësor xxxx.

5. Administratorë të pasurive të sekuestruara caktohen K. Xh. dhe S. M., administratorë pranë Agjensisë së Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara.

6. Ky vendim t'u njoftohet shtetasve A. N. (ose A. L.), A. N., E. N., E. Q. K., si dhe shoqërisë "xxxx" sh.p.k., sipas rregullave procedurale civile.

7. Kundër vendimit lejohet ankim në Gjykatën e Apelit për Krime të Rënda Tiranë brenda 15 ditëve, ky afat për palët në mungesë fillon nga njoftimi i tyre.

Tiranë, më 02.08.2015.

SEKRETARE
OLTA SINANAJ

GJYQTAR
ARDIT MUSTAJ

